



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1001/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Donat Lushaku nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.1001/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Donat Lushaku nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal për vendvotimin VV 1922E/01R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në Komunën e Prishtinës, në Vendvotimin VV 1922E/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1001/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Donat Lushaku nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në vendvotimin VV 1922E/01R ka një shpërputhje të votave që gjenden në kuti dhe votave të evidentuara në

FRK zyrtare e edhe atë të shpallura në ëbfaqen e KQZ-së ngase sipas tij është lëshuar një gabim i paqëllimshëm teknik i kryesuesve të këtij vendvotimi që në vend se në FRK t'i shënojnë 18 vota për kandidatin për Kuvend Komunal të Prishtinës nga radhët e LDK-së – Donat Lushaku me numër rendor në listën e LDK-së i ka shkruar 8 vota pra duke përvjedhur një gabim. Si dëshmi krahas apelit ka bashkangjitur Fleta Llogaritëse për Votat e Kandidatëve për Zgjedhjet për Kuvend Komunal, Formularin e Rezultateve të Kandidatit si dhe një deklaratë të komisionerit nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Andaj përmes apelit ka kërkuar që PZAP të aprovojë apelin dhe ta urdhërojë KQZ-në që të hap kutitë me qëllim të rinumërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Donat Lushaku nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin e lartcekur, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit të vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, nga se rezulton se nga Fleta Llogaritëse për Votat e Kandidatëve për Zgjedhjet për Kuvend Komunal, kandidati për Kuvend Komunal, Donat Lushaku nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka gjithsej 18 vota. Po ashtu edhe nga deklarata e bashkangjitur krahas apelit komisionerit/anëtarit të KVV-së për Lidhjen Demokratike të Kosovës i cili ka deklaruar se në vendvotimin 1922E/01R, kandidati për Kuvend Komunal Donat Lushaku me numër 17, në listën e LDK-së sipas leximit që ka bërë ka pasur 18 vota në këtë vendvotim të cilat janë të evidentuara nga FLICK-në derisa në FRK janë shënuar gabimisht vetëm 8, pra i mungojnë edhe 10 vota të tjera. Andaj edhe paneli konstatoi se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar në mes të FLICK-në dhe në FRK.

Andaj ky panel, vlerësoi se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimit të fletëvotimeve qeverisen nga*

objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës". Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1001/2021 më datën 07.11.2021.

Kryesuesi e Panelit

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.